

03

UDHËZUES XHEPI
PËR SIGURINË

Transporti i sigurt
i bombulave të
gazit

MESSER 
Gases for Life



I nderuar konsumator i gazeve Messer,

Messer prodhon dhe furnizon një gamë të gjerë gazesh në bombula. Transporti i gazeve shoqërohet me disa rreziqe të mundshme. Këshillohet të përdoren shërbimet e një shoqërie të specializuar në këtë fushë për transportin e gazeve - qoftë edhe në sasi të vogla. **Ne mund të organizojmë shpërndarjen e produkteve tona për ju me kënaqësi.**

Kjo broshurë për sigurinë ka për qëllim t'ju informojë në lidhje me masat themelore paraprake që duhet të merren parasysh kur transportoni sasi të vogla gazi me automjet.

Ju lutemi të njiheni me këto informacione themelore të sigurisë para se të transportoni gaze. Për të transportuar gaze në mënyrë të sigurt, është thelbësore që të mos e tejkaloni kapacitetin maksimal të lejueshëm të ngarkimit të automjetit, të siguron ngarkesën dhe të përshtatni kapakët për mbrojtjen e ventilave të bombulave.

Transporti i gazeve rregullohet nga dispozitat e Marrëveshjes Evropiane në Lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme përmes Rrugës (ADR).

Edhe kur rregullat e ADR-së nuk zbatohen (p.sh. për transportin e gazeve si person privat dhe për përdorim thjesht shtëpiak, ose kur nuk tejkalohen kufijtë si më sipër të sasive, etj.), ju duhet të respektoni detyrën e përgjithshme të kujdesit si për të mbrojtur veten dhe të tjerët. Për më tepër, ju jeni të detyruar të respektoni ligjet dhe rregulloret kombëtare në fuqi në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshëm.

Stafi i shoqërisë Messer gjithashtu do t'ju udhëzojë me kënaqësi në trajtimin dhe transportin e sigurt të gazeve.

Ju lutemi rruani këtë fletë sigurie në mënyrë që ta aksesoni lehtë në çdo kohë.

E rëndësishme

Me çdo produkt, Messer ju siguron një fletë të dhënash sigurie që përmban udhëzime të rëndësishme sigurie mbi gazet. Ju lutemi të njiheni me këtë informacion.

Grupi Juaj Messer



Llojet e automjeteve, rregullat themelore dhe kapacitetet maksimale të ngarkesave

Kamionë të hapura

Kamionët e hapur ose kamionët me shtrat të sheshtë me mure anësore preferohen për transportin e bombulave të gazit. Mos e tejkaloni kapacitetin maksimal të ngarkesës së automjetit.



Furgona / Kamionçina të mbyllura

Furgonat / kamionçinat e mbyllura janë automjete në të cilat kabina e shoferit është e ndarë nga shtrati i ngarkesave nga një ndarje të izoluar. Kabina e shoferit duhet të ventilohet veçmas nga hapësira e ngarkesave. Hapësira e ngarkesave mund të ventilohet ose jo. Para shkarkimit, duhet patjetër të dini se mund të jetë formuar një atmosferë e rrezikshme në hapësirën e ngarkesave. Hapni dyert në hapësirën e ngarkesave me kujdes. Mos e tejkaloni kapacitetin maksimal të ngarkesës së automjetit.



Autovetura

Autoveturat shërbejnë për transportin e personave dhe në përgjithësi nuk janë të projektuara për transport të substancave të rrezikshme. Këto automjete janë të pajisura me një sistem të vetëm ventilimi. Mos e tejkaloni kapacitetin maksimal të ngarkesës së automjetit.



Shembujt e sigurimit të ngarkesës janë paraqitje simb

Siguroni ngarkesën në pjesën e bagazhit të autoveturës. Asnjëherë mos e vendosni atë në sedilje ose para ose pas sediljes.

Mbajini dritaret hapur dhe kaloni ventilimin në nivelin më të lartë.

Marrja e bombulave

Sigurohuni që bombula e gazit të ketë etiketën e cila është lehtësisht e lexueshme. Nëse etiketa është e palexueshme ose mungon, mos e përdorni këtë bombul gazit. **Ktheni** bombulën e gazit për një bombul me një etiketë që është në gjendje të mirë.

Sigurohuni që emri i gazit në etiketën e bombulës të përputhet me porosinë tuaj.

Si një përdorues i ri, duhet të pajiseni me **fletën** përkatëse të **të dhënave të sigurisë (FDS)** që përmban udhëzime të mëtejshme të sigurisë për gazin që keni marrë.

Kontrolloni numrin UN (numrin material) për të parë nëse përputhet me numrin UN në FDS dhe në fletën e dorëzimit.

Rreziqet dhe masat paraprake

Presioni në bombulat e gazit është i lartë. Shpërthimi i bombulave të gazit ose ventililit të bombulës mund të shkaktojë lëndime serioze tek personat ose dëmtim të pronës. Ndikimi i nxehtësisë mund të bëjë që çdo ventil sigurie i pranishme të hapet, duke rezultuar kështu në lëshimin e gazit. Nëse lëshohet gaz i lëngshëm, ai avullon dhe prodhon sasi të mëdha gazit.

Mos transportoni mallra të tjera të rrezikshme (psh. ngyrues, bojra, tretës, acide, etj.) ndërkohë që jeni duke transportuar gaze. Mbani me vete një aparat për shuarjen e zjarrit të përshtatshëm për automjete. Mos pini duhan dhe mos përdorni mjete që nxjerrin flakë, si çakmaku, brenda ose në afërsi të automjetit.

Trajtoni bombulat me kujdes dhe shmangni çdo lloj dëmtimi si rezultat i ndikimeve të jashtme. Mos i hidhni bombulat nga automjetet ose rampat kur ngarkoni ose shkarkoni.

Informohuni mbi:

- vetitë e gazeve dhe rreziqet që lidhen me to
- fletën e të dhënave të sigurisë
- transportin e sigurt, ngarkimin dhe shkarkimin e bombulave të gazit
- magazinimin e sigurt të bombulave të gazit
- përdorimin e sigurt të bombulave të gazit dhe pajisjeve përkatëse
- masat e emergjencës

Ngarkesa të përziera

Në përgjithësi, lejohen ngarkesa të përziera të gazeve që përmenden këtu. Marrëveshja Europiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshëm përmes Rrugës (ADR) bëhet plotësisht e zbatueshme nëse sasia e përgjithshme e gazit që do të transportohet mund të kalojë një vlerë prej 1.000 pikave ADR. Në këtë rast, Messer është i detyruar të refuzojë ngarkimin e automjeteve që nuk janë të destinuar për transportin e gazit.



Simbole rreziku | Rreziqet

	<p>Gaze jo të ndezshme, jo toksike Mund të shkaktojë asfiksion.</p>
	<p>Gaze të ndezshëm Mund të shkaktojë zjarr ose shpërthime. Mund të shkaktojë asfiksion.</p>
	<p>Substanca oksiduese (gaze) Në kombinim me materiale të djegshme mund të shkaktojë reagime të fuqishme ose shpërthime. Mund të lehtësojë ndezjen e materialeve dhe do të intensifikojë shumë zjarret.</p>
	<p>Gaze toksike „Lejohet transporti vetëm nga ekspertë “ Rrezik helmimi. Mund të shkaktojë atmosferë toksike dhe është i rrezikshëm për shëndetin përmes thithjes dhe kontaktit me lëkurën.</p>
	<p>Substanca korrozive (gazet) „Lejohet transporti vetëm nga ekspertë “ Rrezik për djegie korrozive (gërryese). Mund të reagojë fuqishëm me ujë ose substanca të tjera. Substancat e derdhura mund të lëshojnë avuji korroziv. Mund të shkaktojë ndryshime të përhershme në indet e lëkurës njerëzore në zonën ku vjen në kontakt dhe të shkatërrojë metalet. Mund të dëmtojë sytë, lëkurën dhe traktin respirator.</p>
	<p>Gaze nën presion Gaz i kompresuar, i lëngshëm, kriogjenik ose i tretur</p>
<p>Azot lëng kriogjenik</p>	<p>Mund të shkaktojë asfiksion dhe djegie kriogjenike. Çdo rrjedhje do të rezultojë në lëshimin e sasive të mëdha të gazit dhe zhvendosjen e ajrit të frymëmarrjes, gjë që mund të shkaktojë përgjumje, humbje të vetëdijes dhe vdekje nga asfiksioni. Kontakti i drejtpërdrejtë me azot lëng mund të shkaktojë djegie kriogjenike.</p>
<p>Akull i thatë (CO₂ i ngurtë)</p>	<p>Mund të shkaktojë asfiksion dhe djegie kriogjenike. Rrjedhja e gazit në brendësi të automjetit zhvendos ajrin e frymëmarrjes dhe mund të shkaktojë përgjumje, humbje të vetëdijes dhe vdekje nga asfiksioni.</p>

SHENIM: Simbolet konvencionale të rrezikut janë renditur në tabelën e mësipërme. Nëse qafa e bombulës suaj është e shënuar me simbole të tjera, **ju lutemi kontaktoni stafin e Messer.**

Transporti i bombulave të gazit

Transportoni vetëm një numër të kufizuar bombulash:*

Lloji i automjetit	Ngarkesa maksimale			
Kamion i hapur/ trailer	Më pak se kapaciteti maksimal i ngarkesës së automjetit ose rimorkios DHE më pak se 1,000 pikë ADR në total			
	Bombula prej 0 - 12 lit. (gjatësia max. 1 metër)		Bombula prej 12 - 50 litrash	
Furgon /Kamionçinë e mbyllur	Vendi i ngarkesës me ventilim të veçantë	Vendi i ngarkesës pa ventilim	Vendi i ngarkesës me ventilim të veçantë	Vendi i ngarkesës pa ventilim
	24	4	12	4
Autoveturë	4 bombula gazi in në pjesën e bagazhit Acetilen: 2 bombula gazi		Nuk rekomandohet transporti	

* Shifrat në tabelë janë vetëm vlerësime. Mund të rezultojnë më të ulëta, në varësi të rrethanave specifike.

Sigurohuni që ventilat e bombulave të jenë të mbyllura. Siguroni të gjithë bombulat gjatë transportit. Siguroni bombulat e gazit në mënyrë që të mos të lëvizin, qoftë edhe në rast aksidenti.

Nëse ventili i bombulës për gaz lëng është i pajisur me një valvul sigurie (psh. Si në rastin e CO₂), transportoni bombulën e gazit duke e lënë të qëndroj në pozicion vertikal.

Kur transportohen duke qëndruar në pozicion horizontal, bombulat e gazit duhet të qëndrojnë ose paralele ose për së gjati në drejtim të kabinës së shoferit. Bombulat e gazit afër pjesës ndarëse duhet të qëndrojnë gjithmonë në kënde të drejta për së gjati. Bombulat bosh duhet të trajtohen me të njëjtën kujdes si ato të plota. Mos transportoni asnjëherë bombula gazi pa mbrojtës të ventilit të bombulës (qoftë një mbrojtës të integruar të ventilit ose një kapuc bombule).

Bombulat e vogla të gazit që nuk kanë mbrojtës të integruar të ventilit dhe bombulat që nuk mund të pajisen me kapuc bombule duhet të transportohen në kosha të posaçëm bombulash që sigurojnë të njëjtin nivel sigurie si bombulat e gazit me mbrojtës të ventilit.

Mos transportoni asnjëherë një bombul gazi në të cilën është vendosur një reduktues i presionit ose pajisje të tjera, edhe nëse ventili i bombulës është i mbyllur. Shkarkoni bombulat e gazit sa më shpejt të jetë e mundur pas mbërritjes në destinacion (sepse ventilimi është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme në automjetet stacionare). Nuk duhet të largoheni asnjëherë nga automjeti duke lënë bombulat e gazit brënda në automjet. Mos përdorni asnjëherë bombulën e gazit në një automjet, përveç nëse automjeti është krijuar posaçërisht për një përdorim të tillë.

Transporti i akullit të thatë (CO₂ në form të ngurtë)

Akulli i thatë duhet të transportohet vetëm në enë të izoluar termikisht që janë të destinuara për këtë qëllim. Kini parasysh që këto enë nuk mbyllen hermetikisht. Akulli i thatë duhet të transportohet vetëm për distanca të shkurtra.

Mos transportoni asnjëherë akull të thatë në thasë plastike, çanta apo ndonjë ambalazh tjetër që nuk është i destinuar për këtë qëllim.

Sigurohuni që ngarkesa të jetë e siguruar siç duhet. Duhet të keni një hapësirë të ventiluar veçmas. Nëse transportoni akull të thatë në një furgon / kamionçinë të mbyllur pa ventilim të veçantë ose në një autoveturë, mbani dritaret hapur dhe kaloni ventilimin në nivelin më të lartë. Mos e lini asnjëherë ngarkesën në automjet gjatë natës. Mos përdorni asnjëherë akull të thatë brenda në automjet. Transportoni vetëm një sasi të kufizuar akulli të thatë:*

Lloji i automjetit	Ngarkesa maksimale	
Kamion i hapur/trailer	Nuk duhet të tejkalohet kapaciteti maksimal i ngarkesës së automjetit / trailerit.	
Furgon/Kamionçinë e mbyllur	Vendi i ngarkesës me ventilim të veçantë	Vendi i ngarkesës pa ventilim
	Kapaciteti maksimal i ngarkesës së mjetit	200 kilogramë
Autoveturë	50 kilogramë (në pjesën e bagazhit)	

* Shifrat në tabelë janë vetëm vlerësime. Mund të rezultojnë më të ulëta, në varësi të rrethanave specifike.



Transporti i azotit lëng (LIN)

Azoti i lëngshëm është një gaz i lëngshëm shumë i ftohtë dhe transportohet në enë kriogjenike të izoluar, **të mbyllura** nën presion ose

në enë kriogjenike të izoluar me vakum, **të hapura** (enë Dewar). Transportoni vetëm një numër të kufizuar të enëve të **mbyllura** kriogjenike:

Lloji i automjetit	Ngarkesa maksimale			
	Enë prej 0 - 50 litrash		Enë prej > 50 litrash	
Kamion i hapur / trailer	Mos tejkaloni kapacitetin maksimal të ngarkesës së automjetit ose trailerit DHE më pak se 1,000 pikë ADR në total			
Furgon / Kamionçinë e mbyllur	Vendi i ngarkesës me ventilim të veçantë	Vendi i ngarkesës pa ventilim	Vendi i ngarkesës me ventilim të veçantë	Vendi i ngarkesës pa ventilim
	5	2	2	1
Autoveturë	1		Nuk rekomandohet transporti	

* Shifrat në tabelë janë vetëm vlerësime. Mund të rezultojnë më të ulëta, në varësi të rrethanave specifike.

Transportoni vetëm një sasi të kufizuar të azotit të lëngshëm në **enët e hapura kriogjene** (enë Dewar): *

Lloji i automjetit	Ngarkesa maksimale	
Kamion i hapur ose trailer	Nuk rekomandohet transporti	
Furgon / Kamionçinë e mbyllur	Vendi i ngarkesës me ventilim të veçantë	Vendi i ngarkesës pa ventilim
	60 litra	10 litra
Autoveturë	10 litra (në pjesën e bagazhit)	

* Shifrat në tabelë janë vetëm vlerësime. Mund të rezultojnë më të ulëta, në varësi të rrethanave specifike.

Duhet të kini parasysh se enët Dewar nuk mbyllen hermetikisht dhe gazi i ftohtë çlirohet herë pas here.

Prandaj ato duhet të transportohen vetëm për **distanca të shkurtra**.

Mos tentoni asnjëherë të mbyllni hermetikisht enët Dewar. Gjatë transportit enët Dewar duhet të qëndrojnë gjithmonë vertikalisht, përndryshe lëngu do të rrjedh.

Sigurohuni që enët kriogjenike të vendosen siç duhet. Sigurohuni që ventilat të jenë të mbyllur (nëse ka). Sigurohuni që kapucët ose mbylljet e ventilave të jenë vendosur saktë (nëse ka). Shkarkoni enët sa më shpejt të jetë e mundur pas mbërritjes në destinacion (sepse ventilimi është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme në automjete stacionare). Mos e lini asnjëherë ngarkesën në automjet gjatë natës. Mos përdorni asnjëherë azot lëng në automjet.

Çfarë duhet të bëni në raste emergjence

Rrjedhjet e gazit

Nëse gazi rrjedh dhe po krijon një atmosferë të rrezikshme në automjet, procedoni, kur është e mundur, si më poshtë: Parkoni automjetin sa më larg që të jetë e mundur nga njerëzit dhe automjetet e tjera, dhe fikni motorin. Ventiloni automjetin duke hapur dyert. Nëse është e mundur ta bëni këtë pa rrezik, përpiquni të mbyllni çdo ventil që mund të jetë i hapur. Mbani larg çdo kalimtar. Mos e vazhdoni udhëtimin nëse nuk mund të garantohet siguria

Nëse gazi që rrjedh është i ndezshëm, gjithashtu duhet të merren parasysh veprimet e mëposhtme:

Fikni çdo burim të mundshëm të ndezjes. Telefononi shërbimin zjarrëfikës. Jepni vendndodhjen tuaj të saktë dhe detajet e sakta në lidhje me ngarkesën tuaj.

Zjarr

Ndaloni menjëherë dhe lini automjetin në një vend të sigurt. Sigurohuni që automjeti është i siguruar siç duhet. Nëse është e mundur ta bëni këtë pa rrezik, mundohuni të shuani zjarrin. Telefononi shërbimin zjarrëfikës.

Aksident trafiku

Nëse përfshiheni në një aksident trafiku ndërsa drejtoni një automjet që transporton gaze, telefononi shërbimin zjarrëfikës. Jepni vendndodhjen tuaj të saktë dhe detajet e sakta në lidhje me ngarkesën tuaj.

Pse nuk këshillohet transportimi i gazeve në furgona ose kamionçina të mbyllura dhe autovetura?



Në situata të caktuara të trafikut, mund të jetë i nevojshëm frenimi emergjent.



Rrjedhja e gazit acetilenit nga ventili e një bombule gazi që mori flakë brenda një furgoni dorëzimi. Shoferi mezi shpëtoi. Automjeti u dogj në vetëm dy minuta.

E rëndësishme

Messer mund të refuzojë ngarkesën për një automjet nëse e konsideron të përshtatshme pas marrjes në konsideratë të automjetit dhe produktit.

Kjo broshurë përmban vetëm informacione themelore. Nuk zëvendëson trajnimin dhe nuk është menduar si e tillë. Kjo broshurë nuk përmban asnjë këshillë juridike në lidhje me transportin e produkteve. Si transportuesi i produktit, ju jeni ekskluzivisht përgjegjës për respektimin e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi si dhe të kërkesave të sigurimit tuaj. Ju gjithashtu jeni i detyruar të siguronit që gazet transportohen në përputhje me rregulloret.



Ju mund të kërkoni **udhëzues** shtesë **xhepi për sigurinë** në faqen tonë të Internetit ose t'i merrni ato direkt nga ekspertët tanë.

Ky udhëzues xhepi shoqërohet me një tutorial në internet.



E rëndësishme

Ky udhëzues xhepi përmban vetëm informacione të përgjithshme. Nuk zëvendëson trajnimet dhe nuk është menduar si i tillë. Messer nuk mban përgjegjësi për informacionet që përmban kjo broshurë.